

Trajnimi sipas standardit ISO 15189

14- 16 Maj 2012 në Athinë të Greqisë

I mbështetur nga projekti PTB, (Institutit Gjerman i Metrologjisë): "Promovimi i Bashkëpunimit Rajonal në Evropën Juglindore në fushën e infrastrukturës së cilësisë," me temën "Akreditimi i Laboratorëve Medicinale" sipas standardit ISO 15189:2007.

Në këtë trajnim treditor morën pjesë nga dy përfaqësues nga Drejtoritë e Akreditimit të Kosovës, Shqipërisë, Bosnje Hercegovinës, Malit të Zi, Kroacisë dhe Maqedonisë.

Sipas agjendës së trajnimit nga Ioannis Sitares dhe Alik Stathopoulou, ESYD, u bë një prezantimi i Përgjithshëm i standardit ISO 15189:2007 (Historia e standarde, si dhe lidhja reciproke me standardet ISO 9001:2000 dhe ISO / IEC 17025:2005) i diskutuan pikat nga 4.1 deri tek pika 4.15. Prezantimin e pjesës teknike të standardit ISO 15189:2007 nga pika 5.2 deri tek pika 5.8 e bëri kryevlerësuesja e ESYD-it, Anna Stefanidou.

Ndërsa prezantimi i aneksit B dhe aneksit C të standardit ISO 15189:2007 u bë nga Ioannis Sitares dhe Alik Stathopoulou, ESYD.